

Dy artistët vlonjatë mblodhën shqiptarët tek studio e Fadil Berishës në Manhattan

Fatmir Velaj solli në SHBA "Kujtimet nga e ardhmja", ndërsa Vasil Qesari magjinë e fotografisë artistike

Nga Dalip Greca

Të dielën e 14 shtatorit tek studio e Fadil Berishës në Avenunë e pestë në Manhattan u promovuan paralelisht dy ekspozita, ajo e piktorit vlonjat me banim në Vjenë të Austrisë, Fatmir Velaj me titull "Memories from the Future"- Kujtimet nga ardhmja dhe ekspozita fotografike e gazetarit televiziv, që jeton në Francë, Vasil Qesari. Edhe pse studio e mjeshtrit të Fotografisë, Fadil Berisha, përfshinë një kat të tërë të ndërtesës 251 në 28 street, ajo dukej paksa e vogël për t'i mbajtur të gjithë mysafirët e këtyre dy ngjarjeve artistike. Vizitorët kishin ardhë jo vetëm nga Nju Jorku, por edhe nga shtete të tjerë, si nga Ohio, Rode Island, Connecticut, New Jersey etj. Ishin të pranishëm edhe zv/ambasadori shqiptar në Kombet e Bashkuara z. Lublin Dilja, konsulli i Shqipërisë në Nju Jork, dr. Albert Jerasi e të tjerë.

Promovimin e organizoi shoqata e Grave shqiptaro-Amerikane "Motrat Qiriazit" nën drejtimin e presidentes, dr. Anna Kohen.

Pasi uroi dy artistët vlonjatë dhe falenderoi pjesëmarrësit e shumtë, në fjalën e saj përshëndetëse, dr. Kohen tha: "Është kënaqësi për mua, dhe auditorin që sot kemi në mesin tonë, piktorin Fatmir Velaj dhe gazetarin Vasil Qesari, të cilët i kanë dhënë kaq shumë artit shqiptar, dhe natyrshëm janë bërë shumë të njohur edhe në sferat e artit evropian dhe atë botëror. Të dy janë nga Vlora, por që këtu vijnë nga dy drejtime të ndryshme, nga Austria dhe Franca, për t'i folur me artin e tyre bashkëkombasve, këtu në NY. Unë nuk do të zgjatem në biografinë e të nderuarve, por marr guximin të them fjalët e John Berger se fotografitë egzistojnë për të na rikujtuar atë që kemi harruar. Në këtë mënyrë apo në një tjetër - ato janë e kundërta e pikturave. Pikturat paraqesin atë që mban mend, kujton piktorin. Meqenëse të gjithë ne harrojmë gjëra të ndryshme, fotografia më shumë se piktura ndryshon kuptim sipas soditësit. Tani, le të ndjekim së bashku ekspozitën."

Më pas gazetari Vasil Qesari, ka përshëndetur pjesëmarrësit. Është një kënaqësi e veçantë, tha ai, që ndodhem mes jush artistë dhe adhurues të artit në Nju Jork. Kjo për mua është një ngjarje e shënuar, një emocion i veçantë një "shok" që po e përjetoj së bashku me ju të dashur miq të mi. Për mua, por besoj se edhe për kolegun tim Velaj, ky është një evenimet i jashtëzakonshëm, këtu në zemër të Nju Jork-ut. Një vend ky që gjithëkush e ka zili. Të ekspozosh në një mjedis të tillë, këtu në Avenjunë e Pestë të Manhattan-it, besoj se çdo artist do ta dëshironte ta kishte këtë fat. Ju faleminderit që na e mundësuat dhe na realizuat një ëndërr.

Duke iu drejtuar pjesëmarrësve, Qesari, shtoi: Nuk ka se si të shprehem ndryshe përpara ju miqve të mi, që ju kam njohur nëpërmjet njohjes virtuale por edhe kontakteve të ndryshme që kemi pasur në disa aktivitete. Më vjen mirë që shkas i këtij takimi është kjo ekspozitë e jona, e para e këtij lloji në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, me kolegun dhe shokun tim, bashkëqytetarin, Fate Velaj.

Më shumë se unë flet vet, ekspozita ime, dhe pikturat e Velajt, pasi ky lloj arti i cili klasifikohet në artet e bukura, natyrisht që "flet" më shumë se autorët." Duke vizituar këtë ekspozitë ju do të bëni edhe vlersimet tuaja, të cilat ne i mirëpresim, tha Qesari.

Më pas ai falenderoi mjeshtrin e fotografisë, Fadil Berishën, që mundësoi promovimin, si dhe dr. Anna Kohen, e njohur si vlonjatja, që ka bërë aq shumë për shqiptarët.

Piktori, Fatmir Velaj, falenderoi organizatorët, pjesëmarrësit, ambasadorin Dilja dhe Konsullin Jerasi; artistët dhe adhuruesit e artit, për pjesëmarrjen në këtë ngjarje të veçantë artistike.

Velaj e konsideroi të dielën e hapjes së ekspozitës si "Ditë artistësh në Nju Jork".

Në mënyrë të veçantë, Velaj falenderoi të gjithë ata që mundësuan hapjen e kësaj ekspozite në zëmër të Nju Jorkut, në "Shtëpinë e madhe të artitëve të mëdhenj amerikanë e botërorë".

- Ekspozimi në Nju Jork, ishte një dëshirë jona, por ajo do mbetej vetëm dëshirë nëse nuk do ta mundësonin atë dr. Ana Kohen, dr. Selahudin Velaj dhe i zoti i kësaj studioje, mjeshtri Fadil Berisha.

Të gjithë së bashku, tha Velaj, erdhëm me idenë të ekspozojmë artin tonë mes jush, dhe kjo ide më në fund sot,

u bë realitet. Ekspozita ka si fokus "Kujtime nga e ardhmja" dhe një cikël të zgjedhur fotosh nga miku im Vasil Qesari, i cili është një "institutcion kulture në vetvete".

Piktori Velaj, duke përcjell tek të pranishmit misionin e kësaj ekspozite tha se "Jemi munduar të sjellim para jush këtu në Nju Jork, në këtë cikël pikturash dhe fotosh, disa nga vlerat më të mirat tona. Jemi munduar të bëjmë një kompozim të bukur të vlerave artistike mes "Bordos, Parisit, Vjenës, Nju Jork-ut dhe Shqipërisë, nga ne dolëm si artistë".

Duke u takuar me shumë artistë shqiptarë gjatë kësaj veprimtarie, Velaj tha se ndjehej i impresionuar nga takimi me kaq shumë artistë shqiptarë:

"Është me të vërtet një kënaqësi e veçantë, të shoh këtu në Nju Jork një botë të tërë artistësh shqiptarë. Kjo është një ngjarje e madhe për mua dhe kolegun tim Vasil Qesari. Por, më lejoni miq të dashur të falenderoj me këtë rast, edhe një nga "pionerët" e parë të emigracionit shqiptar në Amerikë, xhaxhain tim, dr Selahedin Velaj, njeriu që ka bërë aq shumë për çështjen kombëtare dhe na ka ndihmuar shumë ne në këtë ekspozitë. Falenderoj edhe dajën tim Rustem Guri. Përsërites nga zemra mikun tim, artistin që ishte i pari që "hodhi në rrugë" artin socialist, duke e zvëndësuar atë me artin e bukur modern, z. Zini Veshi."

Duke marrë fjalën gjatë ceremonisë promovuese të ekspozitës, dr. Selahedin Velaj tha se ndjehej krenar për nipin e tij, që është një artist i njohur jo vetëm në Ballkan, por edhe në Evropë. Për mua, tha Velaj, është një nga ditët më të bukura. Nipi im është trashëgimtari i njëres prej familjeve më të dëgjura në rrethin e Vlorës. Ai i është i biri i atij që iu thurën këngë. Më vjen mirë që Fatmiri me kolegun e tij Vasil Qesari, erdhën këtu në Nju Jork, mes nesh me këtë ekspozitë shumë tërheqëse. U uroj që të dyve suksese dhe ditë të bukura për të ardhmen".

Artistët u përshëndetën edhe nga konsulli i Shqipërisë në Nju Jork, dr. Albert Jerasi.

Një koktejl i pasur ishte përgatitur me këtë rast. Violinisti Adriatik Sefa, krijoi një atmosferë të ngrohtë muzikore.

Kush është piktori Fatmir Velaj?

Piktori Fatmir Velaj është i njohur për lexuesin e Illyria-s. Është piktor, fotograf, eseist, menaxher arti dhe kurator ndëreuropian. Ai u lind në Vlorë më 1963. Studioi dhe u diplomua për "art-culture management" në Universitetin e Arteve të aplikuara në Vienë të Austrisë. Që nga viti 1991 jeton e punon në Vjenë dhe në Vlorë. Në vitin 2003, Illyria ka përcjellë informacionin se Fatmir Velaj iu dha medalja "Nderi i Republikës së Austrisë" nga qeveria austriake.

Në vitin 2003, Fatmir Velaj është fitues i Medaljes së Artë në Konkursin Internacional të San Remos.

Që nga viti 2001, ai është bërë shumë i njohur përmes veprimtarisë së Forumit Weltoffen International, i cili është organizator i shumë ekspozitave në Ballkan dhe vendet Evropiane.

„Good morning, Balkan" që njihet si krijesë e Fatmir Velaj dhe forumit që ai drejton ka përshkuar një rrugë të gjatë me shumë stacione. Rruga dhe stacionet e kësaj ekspozite nisën në vitin 2003 nga Athina dhe bëri stacione në 2004 në Bukuresht, 2005 në Tiranë, 2006 në Prishtinë e Trieste, 2007 në Ohër të Maqedonisë dhe më 27 nëntor, me ftesë të presidentit të Austrisë Heinz Fischer, do të paraqitet në Pallatin Presidencial Hofburg në Vjenë.

Mesazhet e ekspozitës "Kujtimet nga e ardhmja"

Ekspozita e piktorit Velaj dhe sikli i fotografive të Qesarit, që u promovuan të dielën tek studio e Fadil Berishës, pas Nju Jork-ut do t'i drejtohen Bostonit.

Vizitorët e shumtë në Nju Jork provuan emocione tek ndaleshin pranë pikturave dhe fotografive artistike.

Po çfarë mesazhesh përciell ekspozita "Kujtime nga e ardhmja" e Velajt?

Po sjellim disa nga vlerësimet për këtë ekspozitë, e cila në muajin prill u ekspozua në Universitetin European të Tiranës.

Dr. Alfred Gusenbauer, Bundeskancelar i Austrisë, duke vlerësuar ekspozitën "Memories from the Future" është shprehur :

"Normalisht, është në kundërshtim me rrjedhojën e çdo lloj arsytimi që të kesh 'Kujtime nga e ardhmja'. Deri më sot kjo kategori të menduari i përkiste vetëm Hollivudit. Por, fakt është se secili prej nesh në mënyrë individuale ose kolektive, krijon idetë e tij mbi të ardhmen dhe njëkohësisht, farkëton plane për të nesërmen ose të pasnesërmen. Shpeshherë orientimin e jetës ne e bëjmë përgjatë një linje kohore dhe e ndërthurim atë me

pamje të veçanta, të cilat shpresojmë se një ditë do të na paraqiten ose prej të cilave një ditë do të frikësohemi. Nëse do t'i referohemi përvojës së jetës, fare mirë do të vinim re se me të vërtetë ka një të ardhme të cilën do e kujtojmë. Gjeneratat e prekura nga pesimizmi i ka munduar thënia se 'dikur, bile dhe vetë e ardhmja ka qenë më e mirë', ndërsa ato optimistë, ndiqnin principin e shpresës, ashtu siç bënte Ernst Bloch. E ardhmja ka qenë gjithmonë e panjohur por, mbi të gjitha ajo ka qenë një hapësirë e lirë për fantazi krijuese. Vëmë re se në vitet e fundit ato që me të vërtetë kanë ndryshuar janë zhvillimet dhe rethanat shoqërore mbi të cilat ne thurim plane për të ardhmen, ose më mirë të themi, ëndërrojmë për të. E ardhmja bazohet në pamjet e së tashmes dhe është në një proces ndryshimi të vazhdueshëm. Këtë e tregojnë dhe pikturat e kësaj ekspozite dhe në mënyrë të veçantë fotografitë, që për mendimin tim luhasin ndërmjet melankonisë dhe zgjimit. Por kujt nga ne në Europën Qëndore i kishte vajtur mendja se në pranverën e 1989 me rënien e perdes së hekurt, do të ndodhnin dhe ndryshimet historike? Ndryshimet radikale që ndodhën tek popujt e Europës Juglindore ishin të mendueshme dhe të pranueshme po t'u referohemi historisë së tyre, por e pamendueshme ishte shpejtësia e normalizimit të tyre. Të gjitha këto

larmi ndryshimesh e perspektivash krijuan dhe modele të reja për të ardhmen, ashtu siç dëshmojnë dhe pikturat e Fate Velaj".

Ndërsa dr.Luan Topçiu, ka përcjellë këtë vlerësim "Në ciklin e fundit të tij 'Kujtime nga e ardhmja', titulluar në formën e një sintagme paradoksale dhe sugjестive, Velaj shënon kuotën më të lartë në krijimtarinë e tij. Tablotë e këtij segmenti evokojnë më së shumti përsjattje filozofike dhe poetike mbi botën, mbi jetën, mbi ëndrrën. Veprat janë sinteza përjetimesh të thella, janë thelbi i gjendjeve të ngarkuara shpirtërore dhe emocionale".

Vasil Qesari dhe magjia e fotografisë

VASIL QESARI ka lindur në Vlorë dhe ka kryer studimet e larta në fakultetin Histori - Filologji (dega gjuhë - letërsi). Për shumë vite ka punuar si korrespondent i Radio - Televizionit Shqiptar në Vlorë. Në janar të vitit 1997, krijoi kanalin e parë televiziv lokal të pavarur në Shqipëri, të quajtur Teleblu. Aktualisht jeton në Francë dhe punon si gazetar - reporter në kanalin televiziv francez FRANCE 3. Prej vitesh është anëtar i Shoqatës së Gazetarëve Profesionistë Francezë si dhe veprimtar i organizatave të njohura "Reporters sans frontières" e "Amnistie International ". Mbas botimit, në mars 2000 nga Toena, të librit "44 ditët e Teleblusë", autori paraqitet më pas para lexuesit me librin e tij të dytë "Post - scriptum për diktaturën " ndërkohe sapo ka përfunduar librin « Misteri Montekristo », ku ekskluzivisht për revistën « Pelegrin », po botohet në numrat e saj .

Mbresat nga ekspozita

I pyetur nga Illyria se cilat ishin mbresat që përjetoi gjatë ekspozitës, Qesari u përgjigj:- E harrova fare ekspozitën.E di pse e harrova"? E harrova sepse këtu u krijua një atmosferë e ngrohtë, me shumë emocione, tepër njerëzore.Kam takuar këtu miq të vjetër që kisha vite e vite pa i parë, kam takuar kolegë të Televizionit Kombëtar Shqiptar, kam takuar artistë të fushave të ndryshme të artit, kam takuar shumë e shumë bashkëqytetarë të mi. Kam takuar shumë miq nga Qeparoi, siç i sheh, Spiro Gjikondin, Petro Savën, Astrit Totën nga Borshi...Kolegët e TVSH. E të gjithë më kanë dhuruar emocione të fuqishme.Janë të papërshtueshme mbresat. A kam të drejtë ta harroj ekspozitën!

- Çfarë mesazhesh synon të përcjellësh përmes kësaj ekspozite fotografike ?

- Ekspozita, paraqit Vasil Qesari si njeri, si shpirt, si sentiment.Përmes fotografive që kam realizuar unë përcjell veten. Këtu gjenden momente, çaste, imazhe, të natyrës time, në sensin e kërkimit, të vëzhgimit, dhë të përjetimit poetik të realitetit që më rrethon. Unë ndjek shkollën e Henri Kartier-Breson, babait të fotografisë artistike franceze, i cili ishte një fotograf i shquar, që kultivonte fotografinë-reportaz h, në qendër të së cilës ishte njeriu, jeta e përditshme dhe marrdhëniet shoqërore. Dhe unë jam i prirur në këtë sens, Unë punoj me imazhin sepse ma kërkon këtë dhe profesioni i kameramanit, i gazetarit televiziv.Pavarësisht së është tjetër imazhi televiziv dhe tjetër ai fotografit, por ata i bashkon këndvështrimi artistik, jo teknik.

- Kur shkuat tek fotografia?

- Dikur, shumë shpejt, që në adolishencë, kisha siguruar një aparat fotografik së bashku me të ndjerin Sotir Koçi, sigurova një aparat fotografik "Smjena". Sotiri kishte siguruar laboratorin. Shkonim dhe merrnim solucione për të larë filmin tek reparti i fotografëve të qytetit. Ishte kënaqësi të ecje pas kësaj aventure.